



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 150P/Prot.

7

Tiranë më 10.10.2023

VENDIM

Nr. 45, datë 09.10 2023

“Për miratimin e përfshirjes së lëndëve “Kroatisht” dhe “Maqedonisht”, si lëndë me zgjedhje ekstrakurrikulare, në ciklin e parë të studimeve “Bachelor”, në të gjitha njësitë bazë të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, në Universitetin e Tiranës

Bazuar në ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 3, pika 2, gërma b; neni 38, pika 1, gërma “dh”; në Statutin e Univesitetit të Tiranës neni 31, gërmat f) dhe cc) dhe neni 105, në Rregulloren e Komisionit të Përhershëm të Kurrikulave, si dhe në propozimin e përcjellë nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja me shkresën nr. 51/19 prot., datë 19.05.2023, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës në mbledhjen e datës 09.10.2023;

VENDOSI:

1. Të miratojë përfshirjen e lëndëve “Kroatisht” dhe “Maqedonisht”, si lëndë me zgjedhje ekstrakurrikulare, në ciklin e parë të studimeve “Bachelor”, në të gjitha njësitë bazë të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, në Universitetin e Tiranës, sipas dokumentacionit bashkëngjitur.
2. Ky vendim t’i përcillet për zbatim Fakultetit të Gjuhëve të Huaja.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Prof. Dr. Artan Hoxha

